



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.171/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rustem Thaqi dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjore Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe INTENEWS KOSOVA, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovë (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit të kandidatit të tyre në afërsi të objekteve publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 04.10.2019, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.171/2019 e datës 01.10.2019, e parashtruar nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe INTENEWS KOSOVA ndaj subjektit politik Partia Demokratike e Kosovë (PDK), për shkak të vendosjes së posterit të kandidatit të tyre në afërsi të objekteve publike.

A r s y e t i m

Me datën 01.10.2019, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe IKS, me të cilën pretendon se me datën 01.10.2019, në oborr të shkollës Mihail Grameno në Fushe Kosovë, shihet i vendosur një bilbord i PDK-se, përkatësisht i kandidateve për deputet të kësaj partie, ku sipas paraqitësit të ankesës posterit në fjalë është vendosur në oborrin e kësaj shkolle fillore. Ky veprim sipas paraqitësit të ankesës është në kundërshtim me nenin 33 pika b, të LZP-se, si dhe me Rregullën zgjedhore 13/2013, dhe Kodin për Mirësjellje të subjekteve politike.

Subjekti politik PDK, në përgjigjen thekson se shkelja e pretenduar, nuk është në kundërshtim me LZP-në, pasi që panoja e vendosur është në vendin e destinuar për publikime që është e lejuar nga Komuna e Fushë Kosovës, dhe se vendosja e saj është bërë me marrëveshje me kompaninë ADS D-line, që bënë shfrytëzimin e bilbordit të shkollës Mihail Grameno. Përgjigjes në ankesë i ka bashkangjitur fotot nga vendi në fjalë, si dhe njoftimin e kompanisë ADS D-line.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Duke u nisur nga arsyet e theksuara më lartë, Paneli konstaton se nga ana e subjektit politik PDK, nuk është bërë shkelja e nenit 33 pika (b) të LZP-së, pasi posteri i kandidatit nga subjekti politik PDK, janë vendosur në vendin e dedikuar për reklamim - vendosje të posterave.

Ndërsa lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës se posterat janë vendosur në oborrin e shkollës Mihail Grameno ne Fushë Kosovë, PZAP-i thekson se në këtë periudhe kohore këto veprime nuk janë në kundërshtim me dispozita ligjore. Veprime e parashtruara në ankesë janë të ndaluara vetëm para fillimit të votimit dhe gjate ditës së zgjedhjeve në qoftë se ajo shkolle gjate ditës se zgjedhjeve shërben si Qendër e Votimit ku sipas nenit 85.1 të LZP-së, parashihet që 24 orë para fillimit të votimit të gjitha subjektet politike të cilat nuk kanë larguar materialet e fushatave të tyre zgjedhore të vendosura brenda dhe rreth cilido vendvotim ose qendre të votimit në rreze prej 100 metra, duhet të largohen nga anëtarët e KKV-ve, ose Menaxheri i QV-së, dhe se subjektet politike të cilat nuk i kanë larguar ose janë gjetur duke postuar do të raportohen në PZAP për shkelje të këtij ligji.

Periudha kohore për të cilën parashihet të aplikohet kjo dispozitë ligjore është 24 orë para votimit dhe gjatë ditës së votimit, kurse ankesa është parashtruar gjatë fushatës zgjedhore, Paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme pretendimet e paraqitësit të ankesës, se këto veprime të subjektit politik përbëjnë shkelje të Rregullores 13/2013, dhe shkelje të Kodit të Mirësjelljes nga subjekti politik PDK, pasi që billboardi në fjalë është vendosur në vendin e dedikuar për vendosjen e tyre, ashtu siç vërtetohet nga fotografit e ofruara nga pala ankuese që gjenden në shkresat e lëndës.

Nga arsyet e theksuar më lartë, duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.171/2019 më datën 04.10.2019

Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.